

PRIORITETET NË FUSHËN E

ÇËSHTJEVE TË BRENDSHME

PËR VITIN **2022**



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E BRENDSHME

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
I. KONTROLLI I TERRITORIT, MBROJTJA E MJEDISIT DHE PYJEVE	4
II. ULJA E KËRCËNIMIT DHE NDIKIMIT TË KRIMIT TË ORGANIZUAR	4
III. RITJA E INTEGRITETIT DHE FORCIMI I LIGJSHMËRISË INSTITUCIONALE.....	5
IV. LEHTËSIMI I QARKULLIMIT TË LIGJSHËM TË SHTETASVE DHE MALLRAVE, DUKE I PARAPRIRË ZHVILLIMEVE RAJONALE DHE NISMËS “OPEN BALLKAN”	6
V. KONSOLIDIMI I PROGRAMEVE TË VEÇANTA TË SHTETËSISË.....	7
VI. REFORMIMI INSTITUCIONAL DHE RITJA E PROFESIONALIZMIT	7
VII. SIGURIA PUBLIKE.....	8
VIII. SHËRBIME TË SHPEJTA DHE ME STANDARTE NDAJ QYTETARËVE.....	9
IX. MBËSHTETJA E QEVERISJES VENDORE PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE TË SAJ ..	10

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ministria e Brendshme dhe institucionet e saj do të synojnë përsosjen e sundimit të ligjit, për të garantuar sigurinë në interes të zhvillimit të vendit dhe shoqërisë, përmes:

- *thellimit të luftës kundër çdo forme të krimit të organizuar dhe fenomeneve të jashtëligjshme;*
- *kontrollit të plotë të territorit dhe mbrojtjes së mjedisit;*
- *përmirësimit të shërbimeve ndaj qytetarëve;*
- *mbështetjes me masa konkrete të nismave integruese rajonale e më gjërë.*

Këto objektiva do të mbështeten duke shtrirë inovacionin dhe përdorimin e mundësive bashkëkohore të digjitalizimit në proceset kryesore të veprimtarisë së tyre. Aspekt tjetër i rëndësishëm do të jetë, forcimi i integritetit, profesionalizmi i strukturave dhe përsosja e veprimtarisë së tyre në përputhje të plotë me ligjin dhe në respekt të të drejtave dhe lirive të qytetarëve.

Prioritetet e punës së Ministrisë së Brendshme gjatë vitit 2022 do të përqendrohen veçanërisht në fushat e përgjegjësisë për kontrollin e territorit, luftën kundër krimit të organizuar, me theks të veçantë krimin e ekonomik dhe pastrimin e parave dhe në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarit. Ato do të mbështeten nga një proces i shtrirë digjitalizimi, i cili pritet të sjellë një valë risish dhe përfitimesh për administratën publike, por mbi të gjitha për qytetarët dhe shërbimet që ata marrin.

Veprimtaria e institucioneve të Ministrisë së Brendshme do të shoqërohet me investime moderne duke synuar rritje të efikasitetit të institucioneve dhe të transparencës për shërbimet dhe produktet që ato ofrojnë, si dhe me mundësimin e një bashkëpunimi më të ngushtë e pa pengesa ndërmjet tyre. Ky program pune përbën një platformë të sigurtë dhe me vizion të qartë për nisma e programe afatgjata në procesin e transformimit e të konsolidimit të çështjeve të brendshme në vend.

I. KONTROLLI I TERRITORIT, MBROJTJA E MJEDISIT DHE PYJEVE

Kontrolli i plotë i territorit, mbrojtja e mjedisit dhe pyjeve do të konsolidohet dhe do të garantohet *nëpërmjet përdorimit të teknologjisë* dhe investimeve të konsiderueshme në sistemet e droneve inteligjente dhe ato satelitore për monitorimin e çdo veprimtarie të kundërligjshme dhe kryesisht për sinjalizimin e rrezikut me qëllim parandalimin e tyre.

Rregullimi i marrëdhënieve mes institucioneve me përgjegjësi në këtë fushë, bashkëveprimi i tyre dhe kryerja e aktivitetit operacional me plane dhe procedura të përbashkëta e të njehsuara, pjesëmarrja në Qendrën Kombëtare për Monitorimin dhe Kontrollin e Territorit do të *mundësojë bashkëpunimin më të frytshëm institucional* në interes të realizimit të ambicieve dhe të objektivave të përcaktuara në kontrollin e territorit. *Policia e Shtetit do të marrë një rol të rëndësishëm në kontrollin e territorit* duke u bërë forcë kryesore përgjegjëse për evidentimin e çdo lloj forme jashtëligjshmërie ndaj territorit, mjedisit dhe pyjeve. Njëherësh, veprimet e përbashkëta të Policisë së Shtetit me institucionet tjera do të përqëndrohen në masat parandaluese, si dhe në penalizimin e shkelësve të ligjit. Aksioni i strukturave shtetërore për heqjen e ndërtimeve pa leje në bregdet, në zonat e mbrojtura dhe në interes të planeve kombëtare e rajonale zhvillimore do të intensifikohet më tej.

II. ULJA E KËRCËNIMIT DHE NDIKIMIT TË KRIMIT TË ORGANIZUAR

Ndëshkimi i pakompromis i grupeve dhe organizatave kriminale *nëpërmjet hetimit të çdo pasurie të krijuar nga krimi* dhe duke luftuar financimet e tyre të paligjshme do të shndërrojë *luftën kundër krimit ekonomik* në një prioritet madhor të qeverisë shqiptare. Gjurrimi, gjetja, kapja me qëllim sekuestrimin, konfiskimin dhe rikuperimin e aseteve kriminale do të jetë strategjia e qeverisë për të luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin.

Ky prioritet do të mbështetet me burimet e nevojshme dhe në këtë kuadër Reforma në Policinë Kriminale do synojë krijimin e kapaciteteve të duhura institucionale. Për këtë, do të punohet për rritjen e kapaciteteve investiguese ndaj krimit të organizuar, krimit ekonomik e financiar, duke profilizuar dhe rritur profesionalizmin e strukturave të posaçme në Policinë e Shtetit dhe autonominë e

veprimtarisë së tyre. Këtij qëllimi do ti shërbejë edhe *bashkëpunimi me Policinë Federale Gjermane dhe strukturat e BKA* në nivelin strategjik dhe atë operacional me strukturat e Drejtorisë së Krimit Ekonomik dhe sektorët e luftës kundër pastrimit të parave në Policinë e Shtetit.

Sigurimi dhe *zgjerimi i aksesit të Policisë së Shtetit në regjistrat e llogarive bankare, regjistrin e pronarëve përfitues, të pasurive të paluajtshme, noterëve, transaksioneve të dyshimta, si dhe në databazat e tatimeve dhe doganave* do të garantohet në mënyrë të plotë dhe me ligj. Rritja e hetimeve proaktive dhe e hetimeve bazuar në denoncimet e publikut do të përbëjnë një drejtim të rëndësishëm të punës së strukturave përgjegjëse për këtë qëllim.

Intensifikimi i bashkëpunimit ndërinstitucional të Policisë së Shtetit do të përsoset edhe më tej me prokurorinë, Strukturën e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), Shërbimin Informativ Shtetëror, Njësinë e Inteligjencës Financiare – Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave. Bashkëpunimi ndërkombëtar me strukturat homologe të rajonit do të forcohet nëpërmjet kanaleve të INTERPOL, EUROPOL dhe oficerëve të kontaktit, si dhe nëpërmjet garantimit të aksesit të institucioneve ligjzbatuese në rrjetin SIENA.

Përpjekjeve të mësipërme do t'u shtohet edhe ngritja e institucioneve të reja qeveritare, të specializuara në këtë fushë, siç është *Zyra për Rikuperimin e Aseteve (ARO), ku Ministria e Brendshme dhe institucionet e saj të varësisë janë aktive në konceptimin dhe jetësimin e saj*. Qëllimi final do të jetë mirëadministrimi i pasurive të sekuestruara dhe përdorimi i tyre për qëllime komunitare e sociale dhe për uljen e kërcënimit dhe të ndikimit të krimit të organizuar në shoqëri.

III. RITJA E INTEGRITETIT DHE FORCIMI I LIGJSHMËRISË INSTITUCIONALE

Objektivi ynë për forcimin e integritetit profesional të Policisë së Shtetit dhe garantimin e ligjshmërisë në veprimtarinë e saj do të arrihet nëpërmjet masave të gjithanshme, kryesisht duke përmirësuar ndjeshëm nivelin e *edukimit e të trajnimit të punonjësve të Policisë së Shtetit*, si dhe duke standartizuar mënyrën e veprimit të çdo punonjësi dhe kodin e sjelljes organizative nëpërmjet miratimit të procedurave standarde dhe dokumentave të tjerë me karakter detyrues në veprimtarinë e tyre.

Ministria e Brendshme dhe të gjitha institucionet e saj do të miratojnë planet e integritetit mbi bazën e të cilave do të plotësojnë edhe më tej kuadrin ligjor e normativ të veprimtarisë së tyre, do të përcaktojnë standarte e procedura me synim uljen e riskut ndaj integritetit institucional dhe atij profesional.

Transformimi rrënjësor dhe me një ritëm të përshpejtuar i Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore mbi bazën e përcaktimeve të ligjit të miratuar gjatë vitit 2021 do të ndikojë ndjeshëm në përmirësimin e veprimtarisë së Policisë së Shtetit dhe në respektimin e standarteve profesionale nga ana e saj.

Gjatë këtij viti ndryshime do të bëhen edhe në mënyrën se do të zhvillohet *procesi i vetingut në Policinë e Shtetit* me synim përshpejtimin dhe konsolidimin e tij duke e normuar si një proces të vazhdueshëm për funksionet drejtuese të Policisë së Shtetit dhe ato me risk për strukturat e saj.

IV. LEHTËSIMI I QARKULLIMIT TË LIGJSHËM TË SHTETASVE DHE MALLRAVE, DUKE I PARAPRIRË ZHVILLIMEVE RAJONALE DHE NISMËS “OPEN BALKAN”

Niveli i bashkëpunimit rajonal, tempi dhe dinamikat intensive me tendencë integrimin e plotë të rajonit tonë do të mbështeten me veprime e procese të zhdërvjellta në menaxhimin e qarkullimit ndërkuftar. Ngritja e pikave të përbashkëta të kalimit kuftar mes vendeve të rajonit, aplikimi i procedurave të përshpejtuara dhe shtimi i vendkalimeve kuftare, janë disa nga masat që do të realizohen në këtë periudhë. Gjatë kësaj periudhe synohet digjitalizimi i kontrolleve kuftare me Kosovën në PPKK Morinë - Vermicë për shtetasit dhe automjetet, duke ndërfaqur sistemet e kontrollit kuftar, njehsuar procedurat si dhe duke forcuar operacionet dhe hetimet e përbashkëta për të garantuar sigurinë kuftare.

Këtë vit, me mbështetjen e buxhetit të shtetit, të projekteve IPA si dhe me asistencën e partnerëve do të përsoset modernizimi i kontrollit të vijës së kufirit dhe shërbimeve të tjera në kufi nëpërmjet projekteve teknologjike që janë në proces si dhe instalimit të sistemit API/PNR. Bashkëpunimi me FRONTEX dhe me fqinjët, ngritja në Kakavijë e Qendrës së Bashkëpunimit Policor e Doganor me Greqinë, ngritja dhe operimi i strukturave të përbashkëta hetimore ndërkuftare me Kosovën do të jenë pjesë e masave për përmirësimin e sigurisë kuftare dhe

parandalimin e krimit ndërkufitar dhe trafikeve të paligjshme. Rritja e mëtejshme e bashkëredimit ndërinstitucional dhe marrja e plotë e përgjegjësive nga ana e të gjithë institucioneve, në menaxhimin e integruar të kufirit do të garantojnë gjithnjë e më shumë arritjen e nivelit të përputhshmërisë me standardet europiane dhe me kërkesat e Shengen-it në kontrollin e kufijve shtetërore. Këto masa do të mbështesin fuqishëm edhe politikat dhe programet për menaxhimin e fenomeneve të migracionit që përfshijnë vendin tonë, si destinacion apo edhe transit.

V. KONSOLIDIMI I PROGRAMEVE TË VEÇANTA TË SHTETËSISË

Me synimin për rritjen e atraktivitetit për investime në vend do të vijojë puna e nisur për implementimin e shpejtë të programeve të veçanta të shtetësisë dhe për konsolidimin e Agjencisë për Programet e Veçanta të Shtetësisë. Plotësimi i kuadrit ligjor/nënligjor për programet e veçanta në fushën e ekonomisë, artit, kulturës si dhe në fushën e arsimit e të sportit, përgatitja e kriterëve teknike me qëllim nxitjen e investitorëve të huaj dhe ndërtimi i platformave organizative procedurale e atyre teknologjike do të përbëjnë masat kryesore të veprimtarisë së kësaj fushe. Në këtë drejtim do të shfrytëzohen përvojat më të mira të vendeve të tjera, por edhe angazhimi i ekspertëve të posaçëm.

VI. REFORMIMI INSTITUCIONAL DHE RITJA E PROFESIONALIZMIT

Institucionet e sigurisë në vend do të jenë të përfshira në procese të thella e të gjithanshme reformash dhe transformimi konceptual e strukturor për të mbështetur plotësisht përmbushjen e prioriteteve të qeverisë dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarit. Ato synojnë përmirësime rrënjësore, rritjen e kapaciteteve dhe të efijencës institucionale, si dhe përshtatjen me kërkesat e reja dhe me standartet e vendeve europiane përëndimore.

Reformimi i Policisë Kriminale dhe përcaktimi i drejtë i raporteve dhe marrëdhënieve të saj me institucione relevante ligjzbatuese, por edhe me shërbime të tjera, pjesë të Policisë së Shtetit, do të ngrejë në një nivel më të lartë luftën kundër krimit të organizuar dhe atij ekonomik.

Proceset e nisura vitin e kaluar për konsolidimin e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi do të vijojnë bazuar në planin e masave të miratuar tashmë nga Ministri i Brendshëm. Krahas tyre, do të bëhen ndryshimet e nevojshme në www.mb.gov.al

ligjin për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin, do të fillojë trajnimi institucional i të gjitha kategorive të personelit zjarrëfikës në Akademinë e Sigurisë dhe në stacionet zjarrëfikse, do të vazhdojnë programet e modernizimit të mbështetura nga Njësitë e Vetëqeversjes Vendore dhe nga partnerë që do të rrisin ndjeshëm kapacitetet e këtij shërbimi, si dhe do të ketë një vëmendje të shtuar në trajtimin e personelit dhe menaxhimi i karrierës së tij.

Aplikimi i programeve të digjitalizimit në shërbimin zjarrëfikës do të ndikojë në rritjen e gatishmërisë së tij, përmirësimin e menaxhimit të tij dhe në integrimin e këtij shërbimi, si pjesë e pandarë e kapaciteteve të emergjencave civile.

Rritja e profesionalizimit në fushën e sigurisë publike nëpërmjet institucionalizimit të plotë të edukimit e trajnimit për personelin e institucioneve ligjzbatuese do të jetë objektivi kryesor që do të arrihet për këtë vit. Këtij objektivi do t'i shërbejnë, shndërrimi i Akademisë së Sigurisë në një institucion të vetëm trajnimi për të gjitha këto institucione. Masat e shumta në këtë kuadër siç janë riorganizimi strukturor i akademisë, pasurimi i programeve të trajnimit e edukimit në përputhje me veçoritë që ka çdo institucion, ndërtimi i praktikave të bashkëpunimit të Akademisë së Sigurisë me institucionet përfituese, si dhe miratimi i dokumentit kryesor për edukimin e trajnimin institucional – Politikat e Arsimimit e të Trajnimit - në PSH, GR, etj, janë disa nga masat që do të realizohen këtë vit.

VII. SIGURIA PUBLIKE

Garantimi i sigurisë publike dhe forcimi i zbatimit të ligjit do ketë në fokus *një jetë të sigurtë në komunitet*, garantimin e pronës së qytetarëve, kontrollin e plotë dhe ndëshkimin e çdo sjelljeje antishoqërore, të veprimtarive të paligjshme, veçanërisht atyre me armët dhe eksplozivët si dhe siguri maksimale në shkolla e institucione publike e private. Për këtë, Policia e Shtetit do të transformojë rrënjësisht mënyrën e veprimit dhe të marrëdhënieve me komunitetin, duke u shndërruar në një strukturë të mirëfilltë në shërbim të publikut. Ajo do të bashkëpunojë ngushtë me institucionet përkatëse dhe me qytetarët duke siguruar informacionin e nevojshëm për vlerësimin e risqeve dhe ndërmarrjen e veprimeve proaktive nga ana e saj.

Në interes të kësaj filozofie, zgjerimi i funksionimit të *rrjetit 112 dhe përmirësimi i platformës së Komisarariatit Dixhital* do të realizohen në këtë periudhë. Konsolidimi www.mb.gov.al

i Këshillave Vendore të Sigurisë Publike dhe rritja e rolit të tyre në orientimin e punës dhe veprimtarisë së Policisë së Shtetit do të kontribuojnë edhe më shumë në procesin transformues në PSH.

Përmirësimi i sigurisë rrugore do të mbështetet me programe konkrete modernizimi për monitorimin e trafikut dhe identifikimin e shkelësve të rregullave si dhe digjitalizimin e proceseve që kanë të bëjnë me përdoruesit e automjeteve e sjelljen e tyre në rrugë. Në interes të sigurisë rrugore do të garantohet një angazhim ndërinstytucional dhe mbarëkombëtar, ku çdo institucion me përgjegjësi në këtë fushë do të përmbushë detyrimet e tij ligjore.

VIII. SHËRBIME TË SHPEJTA DHE ME STANDARTE NDAJ QYTETARËVE

Integrimi dhe digjitalizimi i shërbimeve të gjendjes civile bazuar në një sistem të plotë të adresave

Saktësimi i adresës së banimit për çdo shtetas, përfundimi i procesit të integrimit të sistemit të RKGJC dhe të RKA-së, regjistrimi i plotë i shtetasve me banim jashtë vendit dhe adresimi i tyre, digjitalizimi i arkivave të gjendjes civile dhe shfrytëzimi i tyre online, rritja e numrit të zyrave dhe institucioneve shtetërore që do të kenë akses në të dhënat e sistemit të RKGJC-së do të jenë disa nga masat që do të përmirësojnë shërbimet ndaj publikut në këtë fushë.

Ministria e Brendshme do të mbështesë zgjerimin e shërbimeve online me rritjen e përdorshmërisë së Letërnjoftimit-ID dhe të funksioneve të saj në shërbimet qeveritare duke shkurtuar kohën e marrjes së shërbimeve, duke rritur sigurinë e marrjes së tyre përfshirë aplikimin online për fatura e arkëtime, ndërveprimin digjital mes institucioneve shtetërore, etj. Këtë vit do të digjitalizohet mbështetja e zyrave konsullore nga ana e Policisë së Shtetit për verifikimin e identitetit të shtetasve shqiptarë.

IX. MBËSHTETJA E QEVERISJES VENDORE PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE TË SAJ

Gjatë 2022 do të përgatitet Strategjia e re e Decentralizimit dhe Plani i Veprimit për forcimin e mëtejshëm të qeverisjes dhe demokracisë vendore me synim garantimin e implementimit të standardeve evropiane. Në kuadër të mbështetjes së Njësive të Vetëqeverisjes Vendore (NJVV-ve) për ushtrimin e funksioneve të transferuara do të punohet për rritjen e kapaciteteve të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore në përmbushjen e këtyre funksioneve për ofrimin e shërbimeve sipas standardeve. Në këtë drejtim do të forcohet mbikëqyrja e përmbushjes së standardeve të ofrimit të shërbimeve nga NJVV-të, proces i cili garanton cilësinë e tyre. Zbatimi i plotë dhe efikas i funksioneve të transferuara nga ana e NJVV-ve do të varet dhe do të ndihmohet nga përfundimi i procesit të harmonizimit ligjor për këto funksione, nga standardizimi i veprimtarisë së tyre dhe nga koordinimi efikas e monitorimi i afërt i zhvillimit të veprimtarisë së tyre.

Normimi dhe standartizimi i organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar për Parandalim dhe Këshillave Vendorë për Siguri Publike do të rrisë rolin e tyre në menaxhimin e çështjeve të sigurisë publike. Me hartimin e ligjit për Policinë Bashkiake, ndër të tjera do të ketë një ripërcaktim të kësaj të fundit në raport me kundërvajtjet administrative në lidhje me bashkëjetesën shoqërore.